



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 76, datë 7.10.2015

**Për**

**“NJË NDRYSHIM NË ANEKSIN 3 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 49 DATË 11.11.2015 PËR “MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRCAKTIMIT TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE NËNZONAVE TË DESTINUARA PËR PARKIM, SI DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIN TË ADMINISTRUAR NGA BASHKIA E TIRANËS””**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 23, pika 6, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 7, pika 1, shkronjat “e” dhe “f”, pikat 8, 10 e 11 dhe nenit 37 të Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 121 pika 1, 124 pika 1 dhe nenit 125 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar); Nenit 35 të Ligjit nr 9632, datë 30.10.2006 «Për sistemin e taksave vendore» i ndryshuar ; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 39, datë 11.11.2015 “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimin të administruar nga Bashkia e Tiranës”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë ndryshimin e nenit 2.4, Aneksi 3 i Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 49 datë 11.11.2015 për “Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimin të administruar nga Bashkia e Tiranës” si më poshtë vijon:

*“2.4 Tarifat e shërbimit të parkimit mund të paguhen me para në dorë (cash) dhe/ose përmes SMS-ve apo mënyrave alternative të pagesës të mundësuar nëpërmjet telefonisë celulare.*

*Të ngarkojë Tirana Parking për vjeljen e tarifave të shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës me para në dorë.*

*Të ngarkojë Kryetarin e Bashkisë për lidhjen e marrëveshjeve me operatorët e telefonisë celulare, të cilët do të ofrojnë infrastrukturën e telefonisë celulare për administrimin e pagesave të shërbimit publik të parkimit dhe vjeljen e tarifës përkatëse.”*

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Tirana Parking.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**